



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 14

Prishtinë, më 17.3.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe
Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selvie Halimi, Danush Ademi, Doruntinë Maloku, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Nezir Çoçaj dhe Donika Kadaj-Bujupi.

Munguan: Agim Aliu, Fatmir Limaj dhe Milena Miliçeviq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Zahir Çerkini-praktikant në Kuvend, Avni Bytyçi- GLPS; Valdet Hajdini-IKD; Sylë Ahmeti-Kosova Sot, Petrit Hysaj-OSBE; Arton Demhasaj-“Çohu”, Armend Zenelaj-BIRN, Liridon Sadiku-IKPZH, Valmire Hoti-Infodirekt.Tv, Përparim Bublaku-Lajmi.net, Florina Merovci-ZPRK, Artan Canhasi-KDI, Blertë Bejtullahu-EU Office.

Nga Stafi i Komisionit: Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.2.2015;

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i grupit të punës në Projektligjin për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave të cilëve u kufizohet lëvizja më vendim të Gjykatës ose të Panelit për Lirim më Kusht;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i grupit të punës në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-51 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik;
5. Njoftimi i Kryesisë së Kuvendit për formimin e nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të veprimit për monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kundër Korrupsionit 2013-2017;
7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 05/L-09 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

***Kryetarja** konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 23.2.2015;

***Kryetarja** konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 23.2.2015, pa vërejtje.*

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i grupit të punës në Projektligjin për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave të cilëve u kufizohet lëvizja më vendim të Gjykatës ose të Panelit për Lirim më Kusht;

Kryetarja theksoi se grupi i punës ka paraqitur 17 amendamente para Komisionit, dhe ftoi kryesuesin e grupit për të arsyetuar amendamentet.

Armend Zemaj theksoi se raporti ka qenë gati edhe në mbledhjen e kaluar, mirëpo, për shkak të disa ndryshimeve, më tepër të natyrës teknike, si dhe informimit më të mirë të anëtarëve të Komisionit, ne vendosëm që atë ta paraqesim sot. Ajo çka së fundi kemi diskutuar ka qenë çështja e datës së fillimit të implementimit të tij, dhe konsideroj se mund të mbetet afati i parashikuar me projektligj, pra korriku i këtij viti. Andaj, e vetmja arsye që mos të fillojë implementimi i ligjit do të jetë vetëm kostoja financiare, ngase në të gjitha aspektet tjera jemi në rregull.

Sa i përket amendamenteve, vlen të theksohet se ndryshimet që janë bërë kanë konsistuar me përputhshmërinë e tyre me Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale dhe me Ligji për Zbatimin e Sanksioneve Penale. Përgjigjja e pyetjes se pse janë larguar nga fushëveprimi i këtij ligji

personat e liruar me kusht, është se po të njëjtit duke përfitur nga kjo e drejtë, kanë përfunduar pjesën më të madhe të dënimit, dhe kjo shërben si kusht për lirin e tyre, andaj si të tillë ata nuk paraqesin rrezik as për rendin juridik, e as për arratisje nga liria, andaj mbikëqyrja elektronike do të ishte në kundërshtim me kodin penal.

Aspekt tjetër i kësaj çështje është edhe kufizimi i lirisë së lëvizjes, gjë që mund të bëhet vetëm me vendim të gjykatës, andaj Paneli për Lirim me Kusht nuk mund të merr një vendim të tillë, ngase do të ishte në kundërshtim me kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare. Gjithashtu ne kemi vendosur që kompetenca për të realizuar mbikëqyrjen elektronike t'i lihet policisë, ngase konsiderojmë se ky institucion i ka të gjithë parametrat e duhur për ta bërë një gjë të tillë, dhe kjo do t'i shërbente ekonomizimit dhe efikasitetit të çështjes. Prandaj, për fund propozoj që të miratohen këto amendamente, dhe të dërgohen në seancë.

Kryetarja në lidhje me këtë theksoi se problemi i vetëm mbetet kostoja financiare e ligjit, andaj kërkoj nga Ministria e Financave që në rishikim të buxhetit ta futë edhe përfshirjen financiare të këtij ligji.

Nezir Çoçaj falënderoi shoqërinë civile për bashkëpunimin e treguar dhe theksoi se është i gatshëm që gjithmonë të pranojë vërejtjet dhe sugjerimet e tyre për çdo çështje që debatohet në Komision.

Meqë nuk kishe diskutime të tjera, kryetarja konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

P ë r f u n d i m

I. Miratohet Raporti me amendamente i Komisionit;

II. Projektligji për Mbikëqyrjen Elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të Gjykatës ose të Panelit për Lirim me Kusht dhe amendamentet e propozuara, procedohen për shqyrtim sipas kompetencës në komisionet kryesore;

III. Amendamentet e miratuara janë paraqitur si aneks i këtij procesverbali.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i grupit të punës në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-51 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik;

Kryetarja theksoi se kemi punuar si grup i punës në këtë projektligj, dhe kemi bërë disa ndryshime edhe përmbajtjesore për atë që ka qenë e mundur. Ajo arsyetoi amendamentin 6, në bazë të cilit është riformuluar në tërësi neni 16 i ligjit bazik si vijon:

“Neni 16 i ligjit bazik ndryshohet si vijon:

“1. Zyrtarët e lartë publikë nuk mund të jenë menaxhues, kontrollues apo anëtarë të organeve menaxhuese në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse; përjashtuar subjektet politike, funksionet e përcaktuara në nenin 15, paragrafin 2, të ligjit bazik si dhe rastet kur një funksion i tillë dedikohet për shkak të funksionit.

2. Zyrtari i lartë publik nuk mund të ushtrojë veprimtari private, si atë të avokatisë, noterisë, përmbaruesit privat, ekspertë të licencuar, konsulent, agjent apo përfaqësues të organizatave të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni.

3. Zyrtari i lartë publik, nuk mund të ushtrojë në mënyrë aktive të drejtën e pronësisë ose pjesë të pronësisë në një ndërmarrje, pavarësisht nga fusha e veprimtarisë së saj.

4. Zyrtari i lartë nuk mund të ushtrojë më shumë se një funksion në sektorin publik, përveç rasteve sipas detyrës zyrtare, si dhe nuk mund të jetë anëtar i bordit të ndërmarrjeve publike dhe Agjencive të pavarura.

5. Përjashtim nga paragrafi 4 i këtij neni bëjnë rastet e përcaktuara në nenin 10.2 të ligjit bazik.”

Në vazhdim tha se kjo ka qenë e rëndësishme të bëhet ngase në Kosovë kemi 45% të popullsisë papunë, dhe në anën tjetër kemi zyrtarë të lartë publik që kanë nga dy, tri apo katër vende pune.

Armend Zemaj parashtroi një pyetje në lidhje me këtë, e që kishte të bënte se a paraqet konflikt interesi kur zyrtarët e lartë publik janë edhe kryesues të ndonjë agjencie, a ka nevojë të përfshihet edhe kjo në ligj, ngase unë jam për atë që kjo të ndalohej. Nuk ka nevojë që një zyrtar i lartë publik të jetë drejtor edhe në një bord publik?

Kryetarja tha se kjo nënkupton që edhe kryesuesit, por gjithmonë fjalën e kemi pasur për bordet e ndërmarrjeve publike, por nëse ju pajtoheni mund ta shtojmë edhe këtë që të specifikohet sa më drejt. Qëllimi ynë ka qenë që zyrtari i lartë të mos ketë më shumë se një funksion publik, dhe mos të jetë anëtar i bordeve të ndërmarrjeve publike.

Donika Kadaj-Bujupi theksoi se në pajtim me idenë e z.Zemaj, do të ishte mirë që të specifikohen edhe agjencitë, ngase kjo do të pamundësonte interpretim të gabuar të ligjit, dhe do të shmangte situatat që do të bien ndesh me ligjin.

Selviqe Halimi theksoi se i mbështet amendamentet e propozuara. Gjithashtu ajo pyeti se a duhet ndërhy edhe në ligjet tjera që prekin këtë fushë, në mënyrë që të bëhet një rregullim më i mirë i kësaj çështje.

Kryetarja theksoi se propozimet e z.Zemaj dhe znj.Bujupi mund të mirren parasysht dhe të futen në projektligj, ku vetëm shtohen edhe agjencitë e pavarura.

Agim Ademaj tha se është bërë një punë e mirë në këtë drejtim, dhe se duhet të përkrahet si tërësi, por në veçanti amendamenti 6 i këtij projektligji.

Danush Ademi theksoi se i mbështetë të gjitha këto amendamente, por shtroi pyetjen se a nënkupton që ka konflikt interesi në rastet kur kemi edhe asamblistë në kuvende komunale dhe zëvendësministra?

Kryetarja, duke u përgjigjur në pyetjen e z.Ademi, theksoi se kjo gjë rregullohet me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, dhe ne nuk kemi të drejtë të ndërhyjmë aty.

Meqë nuk kishe diskutime tjera, kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P ë r f u n d i m

I. Miratohet Raporti me amendamente i Komisionit;

II. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-51 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe amendamentet e propozuara, procedohen për shqyrtim sipas kompetencës në komisionet kryesore;

III. Amendamentet e miratuara janë paraqitur si aneks i këtij procesverbali.

5. Njoftimi i Kryesisë së Kuvendit për formimin e Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit;

Komisioni duke vepruar në pajtim me vendimin e Kuvendit, nr. 05-V-005, të datës 18 dhjetor 2014, si dhe në pajtim me nenin 70 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 17.3.2015, mori vendim për formimin Nënkomisionit për Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit, dhe e miratoi listën prej 7 anëtarëve për:

I. Nënkomisionin për Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit, si vijon:

- | | |
|--------------------------|-----------------------------|
| 1. Armend Zemaj | G/P (LDK) kryesues, |
| 2. Albulena Haxhiu | G/P (VV) anëtare, |
| 3. Selvije Halimi | G/P (PDK) anëtare, |
| 4. Donika Kadaç – Bujupi | G/P (AAK) anëtare, |
| 5. Enver Hoti | G/P (NISMA) anëtar, |
| 6. Danush Ademi | G/P (6+) anëtar, |
| 7. _____ | G/P (Lista Serbe) anëtar. |

II. Nënkomisioni, fushëveprimin e vet e ushtron në pajtim me shtojcën II (e dytë), pika 16 e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të veprimit për monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kundër Korrupsionit 2013-2017;

Kryetarja para anëtarëve të Komisionit, prezantoi në pika të shkurtra aktivitetet që përmban Planin e veprimit për monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kundër Korrupsionit dhe përbërjen e grupit i cili do të kryesohej nga deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

Armend Zemaj theksoi se do të ishte mirë sikur të raportohet vazhdimisht mbi punën që bëhet në këtë drejtim, nga ana e grupit të punës, ngase do të ishte më e lehtë që të gjithë anëtarët të njoftohen me gjetjet dhe problemet përkitazi me këtë çështje.

Donika Kadaj-Bujupi theksoi se grupi i punës do të hartojë një dokument që përmban metodologjinë e punës së grupit të punës, e që kryesisht do të fokusohet te afatet kohore të raportimit, dhe kjo do të shërbej si lehtësim për grupin dhe Komisionin për të parë rezultatet e gjetjeve që do të dalin gjatë punës së tij.

Selviqe Halimi theksoi se do të jetë mirë nëse njoftohen të gjithë anëtarët e Komisioni për takimet e grupeve të punës, me qëllim që ndonjë i interesuar nga ta, të mund të përcjellë punën e tyre.

Kryetarja pas diskutimeve hodhi në votim Planin e veprimit, dhe konstatoi se njëzëri u përkrah Planin e veprimit për monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kundër Korrupsionit 2013-2017.

7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 05/L-09 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike;

Kryetarja theksoi se kanë marrë amendamentet nga ana e Komisionit për Tregti, Industri dhe Zhvillim Ekonomik, si komision funksional, dhe ato janë gjithsej dhjetë amendamente. Ajo çka është e rëndësishme të theksohet, ka të bëjë me heqjen e rolit të Komunave për shndërrimin e ndërmarrjeve shoqërore në ato publike, ngase kjo është parë si një rrezik për ndërmarrjen “Trepça”.

Armend Zemaj tha në formë pyetjeje se sa është në rregull që me amendamente të ndikohet direkt në ligjin bazik. Sipas tij, kjo mund të jetë e rrezikshme që të shndërrohet në praktikë dhe kjo mund të bie ndesh me rregulloren e Kuvendit. Propozoj që t’i kërkohet Komisionit funksional se pse është ndërhyrë në ligj bazik, ngase mendoj se nuk është mirë të dilet në seancë me këtë propozim që e kemi, pra me ndërhyrje të drejtpërdrejt në ligj bazik. Propozoj që seancës t’i kërkohet me një votë paraprake pëlqimi për t’u ndërhyrë në ligj bazik, ngase ne jemi duke bërë ndryshimet në projektligj, por Kuvendi nuk ka njoftim për ndryshime në ligjin bazik.

Selvije Halimi theksoi se do të ishte mirë të hartohet një raport për seancë, me qëllim të transparencës përballë Kuvendit në lidhje me ndërhyrjet në ligjin bazik, dhe të kërkohet një votë miratuese në lidhje me këtë.

Visar Krasniqi theksoi se ne si Komision kryesor duhet t'ia paraqesim vërejtjet Komisionit funksional, pasi që disa nga amendamentet e propozuara i referohen ligjit bazik dhe kjo bie në kundërshtim me rregulloren e Kuvendit. Andaj, konsideroj se për amendamentet që interferojnë në ligjin bazik, t'i sugjerohet Komisionit Funksional të rishikohen amendamentet prej 7 deri 10.

Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri vendosi që Kuvendit dhe Komisionit Funksional t'ia paraqesë këtë

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 05/L-09 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike dhe amendamentet e propozuara është në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Komisioni paraqet vërejtje të përgjithshme lidhur me amendamentet e propozuara që i referohen ligjit bazik.
3. I sugjerohet Komisionit Funksional që në amendamentin 8 të rishikohet referenca.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.
E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,
Albulena Haxhiu

Aneks

Amendamentet e miratuara për Projektligjin për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të Gjykatës ose të Panelit për Lirim me Kusht Amendamenti 1

Në titullin e Projektligjit, fshihen fjalët “ **ose të panelit për lirim me kusht**”

Amendamenti 2

Në nenin 1 të Projektligjit, hiqen fjalët “ **dhe të panelit për lirim me kusht**”, dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 3

Në nenin 2

Paragrafi 1.1, pas numrit 177, shtohet edhe “**178**” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 1.2 **hiqet, kurse paragrafi 1.3 bëhet 1.2.**

Paragrafi 2 hiqet

Amendamenti 4

Neni 3

Paragrafi 1.1 fjalët “**dhe të panelit për lirim me kusht**” **hiqen** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 1.2, fjala “**subjektit**” hiqet dhe zëvendësohet me fjalën “**personit**” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 1.3, fjalët “**dhe/ose**” hiqen dhe zëvendësohen me “**si dhe**” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 1.4, fjalët “**Shërbimit Sprovues**” hiqen dhe zëvendësohen me “ **Policisë së Kosovës**”, kurse në fund të fjalisë, fjalët “**dhe të panelit për lirim me kusht**” **hiqen.**

Amendamenti 5

Neni 5 riformulohet si vijon:

Neni 5

Nisma për përdorimin e Mbikëqyrjes Elektronike

Gjykata, vendos për përdorimin e Mbikëqyrjes Elektronike me kërkesën e prokurorit, personit, mbrojtësit të tij, prindërve ose kujdestarit të personit të mitur.”

Amendamenti 6

Neni 6

Paragrafi 2 **hiqet** dhe renditja e paragrafëve në vazhdim bëhet sipas numrave me radhë.

Paragrafi 3, fjalët “**ose të panelit për lirim me kusht**”, **hiqen** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 5, fjalët “**apo të panelit për lirim me kusht**”, **hiqen** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 6 **hiqet** dhe renditja e paragrafëve në vazhdim bëhet sipas numrave me radhë.

Paragrafi 8 riformulohet si vijon: “**8. Kundër vendimit nga paragrafi 5 i këtij neni mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit**”

Amendamenti 7

Në nenin 7, pas fjalëve “**Kur është e**” shtohen fjalët “**nevojshme dhe**” kurse në rreshtin e gjashtë, fjalët “**panelit për lirim me kusht**” **hiqen** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 8

Neni 8

Paragrafi 2 riformulohet si vijon: “2. Gjykata, gjatë gjykimit para marrjes së vendimit, mund ti kërkojë Shërbimit Sprovues një raport parandëshkues për të pandehurin dhe nevojën e përdorimit të Mbikëqyrjes Elektronike”.

Paragrafi 3, fjalët “përkatësisht të Panelit për Lirim me Kusht”, hiqen dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 9

Neni 9

Paragrafi 1, fjalët “përkatësisht vendimi i panelit për lirim me kusht për përdorim të mbikëqyrjes elektronike”, hiqen dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 1.4, fjalët “ nëse gjykata, përkatësisht Paneli për Lirim me Kusht urdhëron përdorimin e saj, sipas një afati të caktuar”, hiqen.

Pas paragrafit 1.4 shtohet një paragraf si vijon:” Njoftimin për personin se në rast të mosrespektimit të kushteve nga paragrafi 1 i këtij nenin mund ti revokohet masa”.

Amendamenti 10

Neni 10

Paragrafi 1, fjalët “ Shërbimi Sprovues “ hiqen dhe zëvendësohen me “ Policia e Kosovës” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 2, fjalët” ose të vendimit të panelit për lirim me kusht” hiqen dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 11

Neni 11

Titulli riformulohet si vijon:”Policia e Kosovës”

Paragrafi 1, fjalët “ Shërbimi Sprovues “ hiqen dhe zëvendësohen me “ Policia e Kosovës” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 2 hiqet dhe renditja e paragrafëve në vazhdim bëhet sipas numrave me radhë.

Paragrafi 3 riformulohet si vijon:” 3. Policia e Kosovës, i ofron gjykatës të dhëna të përditësuara për realizimin e Mbikëqyrjes Elektronike, sipas kërkesës së Gjykatës dhe Shërbimit Sprovues.

Paragrafi 4 riformulohet si vijon:” 4. Realizimi i Mbikëqyrjes Elektronike dhe mënyra e raportimit nga ana e Policisë së Kosovës përcaktohet me akt nënligjor i nxjerrë nga Ministria e Punëve të Brendshme.”

Amendamenti 12

Neni 12

Paragrafi 1.3 dhe 1.5, fjala “ subjektit” hiqet dhe zëvendësohet me “personit” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 13

Neni 14

Paragrafi 3, fjala “ subjektit” hiqet dhe zëvendësohet me “personit” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 3.2 hiqet

Paragrafi 3.3, fjalët” ose vendimin e panelit për lirim me kusht” hiqen.

Amendamenti 14

Neni 16

Paragrafi 1.1, fjalët” apo vendimin e panelit për lirim me kusht” hiqen.

Paragrafi 1.2, fjalët “ose panelit për lirim me kusht” hiqen dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 1.5, fjalët “funksionimin në kushte jonormale të saj” hiqen dhe zëvendësohen me fjalët “mosfunksionimin e saj”

Amendamenti 15

Neni 17

Në titull fjalët “ose vendimit të panelit për lirim me kusht” hiqen.

Paragrafi 1 në fund të fjalisë, fjalët “për përdorimin e Mbikëqyrje Elektronike”, hiqen.

Paragrafi 2 në rreshtin e tretë, fjalët “nga çasti” hiqen dhe zëvendësohen me “nga momenti” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 3 riformulohet si vijon: “3. Nëse personi dhe personi i afërt nuk mund të kontaktohen, salla operative njofton menjëherë Policinë, duke ia përcjell informacionin për vendndodhjen e personit. Salla operative, brenda 24 orëve, njofton gjykatën dhe prokurorinë për shkeljen, dhe veprimet e kryera.

Paragrafi 5, në rreshtin e tretë, fjalët ”Shërbimi Sprovues “ hiqen dhe zëvendësohen me “Gjykata apo Prokuroria “dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 16

Neni 18

Paragrafi 1 riformulohet si vijon:” 1. Policia e Kosovës vënë në dijeni gjykatën përkatëse, sapo të marrin njoftimin për shkeljen e kushteve të Mbikëqyrjes Elektronike”.

Paragrafi 2 riformulohet si vijon:” 2. Policia, kur vlerëson se janë shkelur qëllimisht, ose në mënyrë të përsëritur, kushtet për përdorimin e Mbikëqyrjes Elektronike, e harton raportin, të cilin ia paraqet gjykatës brenda 48 orëve.”

Paragrafi 3 riformulohet si vijon:” 3. Raporti detal i hartuar në rastet e parashikuara nga paragrafi 2 i këtij neni, i paraqitet të njëjtës gjykatë që ka vendosur përdorimin e Mbikëqyrjes Elektronike.

Paragrafi 4 riformulohet si vijon:” 4. Gjykata, pasi vlerëson të gjitha rrethanat, vendos për vazhdimin apo ndërprerjen e Mbikëqyrjes Elektronike”.

Amendamenti 17

KREU V riformulohet si vijon:

” DISPOZITA KALIMTARE

Neni 19

Aktet nënligjore

Ministria e Drejtësisë brenda gjashtë 6 (gjashtë) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nxjerr aktet nënligjore për zbatimin e tij.

Neni 20 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, ndërsa fillon të zbatohet nga 1 korriku i vitit 2015.

Amendamentet e miratuara për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-51 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Amendamenti 1

Në tërë tekstin e Projektligjit, pas fjalës **“ligjit”** shtohet fjala **“bazik”**, në rastet kur i referohet ligjit bazë.

Amendamenti 2

Neni 1 i Projektligjit ndryshohet si vijon:

“ 1. Në ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (më tej: ligji), përfshihet edhe kategoria e zyrtarëve të lartë publikë të përcaktuar sipas ligjit nr. 04/L -228 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.”

Amendamenti 3

Neni 3 i Projektligjit hiqet dhe radhitja e neneve vazhdon sipas radhës.

Amendamenti 4

Neni 5 paragrafi 3, para fjalëve”**bashkëaksionarëve**” shtohet “**si dhe** “

Amendamenti 5

Neni 6 i Projektligjit ndryshohet si vijon:” Neni 12, paragrafi 2 i ligjit bazik riformulohet si në vijim:

2. Nëse ndaj zyrtarit të lartë gjatë dhe lidhur me ushtrimin e funksionit publik ushtrohet ndikim i drejtpërdrejt apo i tërthortë, haptazi apo në mënyrë anonime për të votuar apo për të marrë vendim konkret, ai njofton me shkrim institucionin që e ka zgjedhur apo emëruar si dhe Agjencinë e cila pas shqyrtimit do të vendosë nëse ka bazë të lajmërohen organet e ndjekjes.

Amendamenti 6

Neni 9 i Projektligjit ndryshohet si vijon:

“Neni 16 i ligjit bazik ndryshohet si vijon:

“1. Zyrtarët e lartë publik nuk mund të jenë menaxhues, kontrollues apo anëtarë të organeve menaxhuese në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse; përjashtuar subjektet politike, funksionet e përcaktuara në nenin 15, paragrafin 2 të ligjit bazik si dhe rastet kur një funksion i tillë dedikohet për shkak të funksionit.

2. Zyrtari i lartë publik nuk mund të ushtrojë veprimtari private, si atë të avokatisë, noterisë, përmbaruesit privat, ekspert të licencuar, konsulent, agjent apo përfaqësues të organizatave të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni.

3. Zyrtari i lartë publik, nuk mund të ushtrojë në mënyrë aktive të drejtën e pronësisë ose pjesë të pronësisë në një ndërmarrje, pavarësisht nga fusha e veprimtarisë së saj.

4. Zyrtari i lartë nuk mund të ushtrojë më shumë se një funksion në sektorin publik, përveç rasteve sipas detyrës zyrtare, si dhe nuk mund të jetë anëtar i bordit të ndërmarrjeve publike dhe Agjencive të pavarura.

5. Përjashtim nga paragrafi 4 i këtij neni bëjnë rastet e përcaktuara në nenin 10.2 të ligjit bazik.”

Amendamenti 7

Neni 12 të Projektligjit, paragrafi 1, në rreshtin e parë hiqet fjala “ **ushtron**” dhe zëvendësohet me fjalën “**paraqet**”, kurse në rreshtin e katërt, pas fjalëve “**e që**” shtohen fjalët “ **mund të** “ dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 2, në rreshtin e parë hiqet fjala “ **procedimin**” dhe zëvendësohet me fjalën “**procedurën**” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 3, në rreshtin e parë hiqet fjala “ **procedimin administrativ dhe/ose**” dhe zëvendësohet me fjalën “**procedurën administrative ose gjyqësore**” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.